



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"
UNIVERSITY OF PRISHTINA

Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +381 38 244 183 • E-mail: rektorati@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

Nr. Prot.: 798
Datë: 15/4/2022


Rektori i Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", bazuar në kompetencat e përcaktuara sipas nenit 28, paragrafi 1.6 të Statutit të UP-së dhe nenin 6 të Rregullores nr. prot. 1/131, datë 1.6.2015 të punës së Senatit të UP-së, thërret mbledhjen e 26-të të Senatit të Universitetit të Prishtinës, me këtë:

R E N D I T E

1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së 25-të të Senatit të UP-së, mbajtur me datë 7.3.2022;
2. Plotësimi dhe ndryshimi i Rregullores me nr. 191, datë 16.2.2021 për procedurat përzgjedhëse lidhur me emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina";
3. Plotësimi dhe ndryshimi i Rregullores me nr. 192, datë 16.2.2021 për procedurat përzgjedhëse lidhur me emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik në Fakultetin e Arteve të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina";
4. Shqyrtimi i kërkesës së prof. dr. Suzana Manxhuka - Kërliu, dekane e Fakultetit të Mjekësisë, për lirimin me pagesë nga procesi mësimor për gjashtë (6) muaj, nga data 1 maj 2022-30 shtator 2022) të dr. sci. Dafina Bytyçi, asistente mësimore, me qëllim të përmbushjes së obligimeve si bursiste në Universitetin "Johns Hopkins" të Baltimorit (SHBA) në kuadër të programit Fulbright;
5. Shqyrtimi dhe miratimi i propozimeve të KQSD-së për lejimin e temave të doktoratës dhe të mentorëve, sipas raportit të KQSD-së;
6. Shqyrtimi i kërkesave për ratifikim të punimeve të doktoratës, sipas raportit të KQSD-së;
7. Shqyrtimi dhe vendosja lidhur me raportet me nr. prot. 1/7, datë 8.4.2022 dhe nr. prot. 1/9, datë 8.4.2022 të Komisionit për ankesa dhe parashtrës të Senatit;
8. Të ndryshme.

Mbledhja do të mbahet ditën e martë, më datë 19.4.2022, me fillim prej orës 14:00.

P.S.: Në zbatim të masave për parandalimin dhe luftimin e pandemisë Covid-19, të pranishmit obligohen t'i mbajnë maskat dhe ta ruajnë distancën fizike nga njëri-tjetri.

Kryesues i Senatit të UP-së

Prof. dr. Naser Sahiti, rektor

